

---

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR  
Hydrodynamic Systems HDS.  
SH.P.K**

---



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME  
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
Hydrodynamic Systems HDS.  
SH.P.K.**

**KREU I**

**EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1**

**EMRI I SHOQËRISË**

1.1 Sot,në Tiranë më datë 20.07.2020, ne të nënshkruarit:

**Lulzim Kapllanaj**, atësia Isuf, shtetas Shqiptar, lindur në Fratar, Fier, me datë 15/11/1984 dhe banues në Tiranë, identifikuar me me letërnjoftim nr. 030037956, numër personal I41115138A, madhor dhe më zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Jani Karamano**, atësia Jorgo, shtetas Shqiptar, lindur në Vrisera, Gjirokastër, me datë 27/07/1974 dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftim nr. 036105701, numër personal H40727016P, madhor dhe më zotësi të plotë juridike për të vepruar.

themelojmë këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **Hydrodynamic Systems HDS. SH.P.K.**

(Më poshtë e quajtur "**Shoqëria**")

**NENI 2**

**SELIA**

2.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresen: Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tirane - Durres, Km. 3,pas Universitetit Kristal, Rruga "Themistokli Gërmenji".

2.2 Ortakët mund të vendosin mbi transferimin e selisë së shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

3.1Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



## NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj riparimin, Riparim, i mjeteve motorrike dhe motorrçikletave. Shit-blerjen me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industrial, makineri e paisje, materiale ndërtimi, automjete, vajra lubrifikantë, duke përcaktuar, por pa kufizuar veprimet e papërmëndura: krijimi i sistemeve elektroenergjitike, prodhim, import-eksport të energjisë elektrike me të gjitha format që njih teknologjia. Shit-blerjen e energjisë elektrike tek operatorët lokal apo ndërkombëtar, sipas legjislacionit dhe lejeve të organeve kompetente.

Shoqëria gjithashtu mund të realizojë bashkëpunime me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objektiv ose të ngjashëm me atë të shoqërisë, si dhe në raste të vecanta në sektorë të tjerë, bashkëpunime me persona fizikë, vetëm nëse keto veprime janë të quajtura të nevojshme ose të duhura për realizimin e objektivit të shoqërisë nga organi administrativ.

4.2 Për më tepër shoqëria mund të veproje si agent/ndermjete për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme dhe bazuar në diskrecionin e saj të vetëm mund të kontraktoje palë të treta për kryerjen e një pjese apo të të gjitha shërbimeve të mesiperme.

4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit të shërbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave etj.

4.4 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shiptare apo të huaja, si edhe të hyje në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publike, vendas ose të huaj.

## KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE

### NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100.000 Lekë, i përbërë nga 2 (dy) kuota, të ndarë si më poshtë:

Lulzim Kapllanaj, person fizik, zotërues i 1 (një) kuote me 75% (shtatëdhjetëpesëpërqind) dhe vlerë 75.000 Lekë.

Jani Karamano, person fizik, zotërues i 1 (një) kuote me 25% (njëzetëpesëpërqind) dhe vlerë 25.000 Lekë.

Derdhja e kapitalit do të kryhet pas regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë.





## NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT

6.1 Transferimi i kuotave të kapitalit të shoqërisë mund të bëhet me shitje, trashëgimi, ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

6.2 Në rast transferimi të kuotave tek persona të tretë jashtë Shoqërisë, qoftë me shitje qoftë me dhurim, ortaku që synon të transferojë kuotat duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes të kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta, dhe duhet ta ushtrojne këtë të drejtë brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të ortakut për të transferuar kuotat.

6.3 Vlera e kuotës që transferohet do të përcaktohet nga një ekspert i emëruar nga ortakët me marrëveshje ose nga gjykata në rast se ortakët nuk bien dakort.

## NENI 7 BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT

7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale

## KREU III ORTAKËT E SHOQËRISË, FINANCIMET

### NENI 8 ORTAKËT

8.1 Ortakët e shoqërisë janë:

Lulzim Kapllanaj, atësia Isuf, shtetas Shqiptar, lindur në Fratar, Fier, me datë 15/11/1984 dhe banues në Tiranë, identifikuar me me letërnjoftim nr. 030037956, numër personal I41115138A, madhor dhe më zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Jani Karamano, atësia Jorgo, shtetas Shqiptar, lindur në Vrisera, Gjirokastër, me datë 27/07/1974 dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftim nr. 028832418, numër personal H40727016P, madhor dhe më zotësi të plotë juridike për të vepruar.

### NENI 9 ORGANET E SHOQËRISË

9.1 Organet e shoqërisë janë:

a) Asambleja e Përgjithshme;



b) Administratorët.

## **Neni 10** **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërise dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht.

10.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

10.3 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji për shoqëritë tregtare, ligje të tjera, dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

10.4 Asambleja e Përgjithshme mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vënd tjetër të shënuar në njoftimin për mbledhje. Njoftimi për mbledhje i dërgohet me shkrim të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

10.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratorët. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortaku ose ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme.

10.6 Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të zakonshme e jashtezakonshme.

## **Neni 11** **ASAMBLEJA E ZAKONSHME**

11.1 Asambleja e zakonshme mblidhet, çdo vit brënda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, për miratimin e raportit të administratorëve, inventarëve dhe llogarive vjetore.

11.2 Vendimet merren më shumicë të zakonshme të votave në prani të ortakëve me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50 % të kuotave.

11.3 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 11.2, Asambleja do të mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njejtin rend dite. Në rast se as në mbledhjen e dytë nuk arrihet kuorumi, ortakët e pranishëm ose rregullisht të përfaqësuar do të përbëjnë kuorumin.

## **Neni 12** **ASAMBLEJA E JASHTËZAKONSHME**

12.1 Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të jashtezakonshme sa herë është e nevojshme për marrjen e vendimeve në interes të Shoqërisë.



5



12.2 Vendimet që kanë të bëjnë me (por pa u kufizuar vetëm në to): ndryshimin e neneve të Statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, ndryshimin thelbësor të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, prishjen e Shoqërisë konsiderohen vendime të jashtezakonshme.

12.3 Vendimet e jashtezakonshme merren nga Asambleja e Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave në prani të ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.

12.4 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikes 12.3, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 diteë me të njëjtin rend dite. Në rast se në mbledhjen e dytë nuk arrihet kuorumi, ortakët e pranishëm ose rregullisht të përfaqësuar do të përbëjnë kuorumin.

### **Neni 13** **PJESËMARRJA, VOTIMI DHE PËRFAQËSIMI**

13.1 Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe votimit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak janë në numër të barabartë me kuotat e zotëruara prej tij.

13.2 Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë me autorizim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 14** **KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**

14.1 Asambleja e Përgjithshme vendos për:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshimin e Statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/eve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre;
- e) mbikyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
- h) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) perfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera në kundër administratorit/eve;



- j) shpërndarjen e fitimeve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
  - m) çështje tjetër të caktuar nga ligji ose nga ky Statut.
- n) Kërkesa për kredi bankare dhe / ose nënshkrimin të faturave, garanci ose garanci në favor të palëve të treta

## NENI 15 FINANCIMI I SHOQËRISË

15.1 Organi i administrimit të shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përvec rasteve të zmadhimit të kapitalit ka të drejtë të kërkojë nga ortakët e Shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë

15.2 Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen këto fonde.

## KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 16 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

16.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator ;

- **Znj.Energesa Marishta**, e datëlindjes 28/04/1987, lindur në Vlorë, banuese në Tiranë, e identifikuar me letërnjoftim nr.034032658 dhe numër personal I75428069P, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

e cila emërohet nga ortakët e shoqërisë për një periudhë 5 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

Administratori shkarkohet nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

Administratori ka kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

- a) mbikeqyr dhe zbaton politiken e biznesit të shoqërisë;
- b) përfaqëson shoqërinë;
- c) kujdeset që shoqëria të zbatojë ligjet dhe standartet e mbajtjes së llogarive;
- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklaram tjetër i detyrueshëm sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet;





- f) siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabël të çertifikuar dhe raporti i llogaritave publike të çertifikuar t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme;
- g) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;

16.2 Administratori mund të ndërmarrë apo të kërkoj kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve apo organeve të tjera të Shoqërisë.

### **NENI 17 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

17.1 Shpërblimi i administratorit të shoqërisë do të përcaktohet nga Ortaku i shoqërisë.

### **KREU V KONTROLI KONTABËL I SHOQËRISË VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

#### **NENI 18 KONTROLI KONTABËL**

18.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabel të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortakët do të emerojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në baze të ligjit.

#### **NENI 19 VITI FINANCIAR**


19.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti.

#### **NENI 20 BILANCI DHE REZERVAT**

20.1 Me mbylljen e secilit vit financiar Administratorët marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur në mënyrë që ortaket të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

20.2 Ortaket vendosin mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

20.3 Ortaket në cdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre





## KREU VI PRISHJA DHE NJOFTIMET

### NENI 21 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

21.1 Në rastin e likuidimit të shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqeritë Tregtare"

### NENI 22 NJOFTIMET

22.1 Të gjitha njoftimet kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nese ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre prane Administratoreve të Shoqërisë.

22.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.

22.3 Në rastin kur një kuote zotërohet nga më shume se një përsone të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqesuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

## KREU VII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE


### NENI 23 LIGJI I ZBATUESHËM

23.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themelimin, Statutin dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushën e shoqërive tregtare.

23.2 Ky akt hartohet në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortakët themelues, firmoset si më poshtë prej tyre.

Ortakët Themelues:

**Lulzim Kapllanaj**



**Jani Karamano**

